

10594

20.05.2016



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANË

Nr. i Regjistrimit Themeltar 5633/1201/46
Data e Regjistrimit 01.07.2014

Nr. i vendimit 1187
Data e vendimit 12.05.2016

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Apelit, e formuar si trup gjykues, në përputhje me parashikimet e nenit 12, pika 2, shkronja “a”, të ligjit Nr. 49/2012, datë 12.05.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji Nr. 49/2012), nga gjyqtarët:

Amarildo
Lindita
Bari

LAÇI
SINANAJ
SHYTI

KRYESUES
ANËTARE
ANËTAR

Asistuar nga sekretarja gjyqësore, **Mimoza Lazri**, në Tiranë, sot në datë **12.05.2016**, mori në shqyrtim në **dhomë këshillimi**, sipas parashikimeve të nenit 49, të ligjit Nr. 49/2012, çështjen me Nr. 5633/1201/46 akti, datë 16.09.2014, që iu përket:

PADITËSE: **SHOQËRIA “SILVI KONSTRUKSION” SHPK**, me adresë, Lagjia “Konferenca e Pezës”, Fier.

E PADITUR: **DREJTORIA RAJONALE TATIMORE, FIER.**

OBJEKTI: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi të detyrimit tatimor Nr. 13556 Prot., datë 09.09.2011, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.

BAZA LIGJORE: Neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative; Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin Nr. 1756, datë 20.09.2012, ka vendosur:

- Pranimin e kërkesë padisë.
- Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, Njoftim Vlerësimi Tatimor Nr. 13556, datë 09.09.2011, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Vlorë brenda 15 ditëve nga e nesërmja e shpalljes.

Kundër vendimit Nr. 1756, datë 20.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, në datë 08.10.2012, nëpërmjet shërbimit postar shtetëror, ka paraqitur ankim pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë:

- Nga të ardhurat e deklaruar të palës paditëse, Shoqëria "Silvi Konstruktion" SHPK, në situatën financiare të TVSH-së, sistemit informatik për periudhën e kontrolluar të vitit 2010, është në vlerën 5 537 000 lekë.
- Nga kontrolli rezultoi se ky ndryshim vjen si rezultat i rivlerësimit të shitjeve të kryera, nga akt kontrolli nr. 10486, datë 20.07.2011, por që në kundërshtim me nenin 128 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, pasi duhet të rivlerësohen edhe të ardhurat për efekt të tatim fitimit, pasi është një periudhë e mbyllur tatimore dhe si rezultat lindin detyrimet si më poshtë:

Detyrim tatim për vitin 2010	$5\,537\,000 \times 10\% = 553\,700$ Lekë
Gjohje tatim fitimi	= 276 850 Lekë
TOTALI	= 830 550 Lekë
- Karburanti i konsumuar dhe vaji është në shërbim të aktivitetit të shërbimit të kryer ndaj kompanisë "Stream Oil & Gaz" shërbim i përjashtuar nga TVSH, por gjithashtu edhe blerjet janë të përjashtuar nga TVSH. Duke iu referuar shitjeve të subjektit, edhe pjesa e kreditueshme e karburantit do të njihet. Për sa me sipër dhe në mbështetje të ligjit me nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 115, lindin detyrimet si me poshtë: Detyrim TVSH = 200 032 lekë. Gjohje TVSH = 50 008 lekë. Totali = 250 040 lekë.
- Referuar tabelës se konsumimit të karburantit rezulton se mesatarja mujore e konsumimit është rreth 500 000 lekë, kurse subjekti në muajin dhjetor 2010 ka blerë 4 213 551 lekë, kur totali i shitjeve për këtë muaj është 5.8 milionë lekë. Subjekti ngre pretendimin e konsumimit të sondave të dhëna me qira, por në asnjë kontratë qiraje të paraqitur nga ana e subjektit nuk thuhet se karburanti për sondat do të përballohet nga vetë subjekti dhe, për me shumë, në muajin e fundit. Pra subjektit do t'i njihet si shpenzim karburanti për muajin dhjetor 2010 mesatarja e muajve të tjerë. Pjesa tjetër e blerë në muajin dhjetor 2010, do të klasifikohet shpenzim i panjohur në vlerën 3 700 000 lekë, në mbështetje të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", neni 115.
- Nga kontrolli i dokumentacionit, referuar edhe pasqyrave financiare të vitit 2010, subjekti "Silvi Konstruktion" SHPK, është investitor i një pallati në lagjen "Konferenca e Pezës", Fier. Sipas llogarive kontabël të subjektit vlera e apartamenteve të banimit është 98 897 699 lekë. Nga kontrolli rezultoi se subjektit, sipas kërkesës se tij për t'u pajisur me vërtetim në vitin 2007, për efekt hipotekimi, i është llogaritur tatim fitimi në shitje me tregues minimalë fiskalë, të cilin subjekti e ka paguar, por që nuk është pasqyruar në situatën financiare të shoqërisë. Subjekti, në bazë të kërkesës Nr. 888, datë 21.08.2009, ka kërkuar kompensimin e këtij tatimi për të mbuluar tatim fitimin e veprimtarive të tjera, gjë që është në kundërshtim me shkresat dhe Udhëzimet e Ministrisë së Financës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se subjekti ka deklaruar të shitura deri tani 1623 m² apartamente banimi me çmim mesatar 27 754 lekë, çmime nën treguesit minimalë fiskalë dhe çmime shumë poshtë tregut.
- Nisur nga fakti që subjekti është pajisur me vërtetimin përfundimtar për efekt të hipotekimit dhe që nuk deklaron më apartamente banimi të shitura, edhe pse janë të

banueshme, referuar dokumentacionit janë 4196 m² apartamente që subjekti ka, duhet të llogarisim detyrimin mbi tatimin minimal në shitje .

- Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 173, datë 29.03.2006, "*Mbi miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes se banesave, fitimi minimal fiskal për zonën e Fierit*", si dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2, datë 26.02.2009, për ndryshimin e udhëzimit Nr. 9 datë 26.02.2008, "*Për tatim fitimin në kalimin e pronësisë se paluajtshme*", ku fitimi minimal për m², të apartamenteve është 40 Euro/m, është llogaritur fitimi minimal i shoqërisë që do të realizojë në shitje, pasi të ketë hipotekuar objektin. Gjjobat dhe interesat që lindin nga sistemi informatik nuk janë llogaritur në detyrimet e aktit.
- Njoftim vlerësimi me numër 13556 datë 09.09.2011, dalë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, është i bazuar në ligjin me Nr. 9920 datë 19.05.2008, "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, në nenin 115, në nenin 128, dhe në nenin 124, ligjit me Nr. 8438 datë 28.12.1998, "*Për Tatimin mbi të Ardhurën*", dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave me numër 173 datë 29.03.2006, "*Mbi miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes se banesave, çmimi minimal fiskal për zonën e Fierit*", si dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave me Nr. 2 datë 26.02.2009 për ndryshimin e Udhëzimit Nr. 9 datë 26.02.2008, "*Për tatim fitimin në kalimin e pronësisë se paluajtshme*".
- Ndërsa në lidhje me pretendimin e palës paditëse për tatimin e fitimit në shitje, që nuk i takon ta paguajë se apartamentet nuk janë shitur dhe ky tatim paguhet në momentin e shitjes se apartamentit, po ju shpjegojmë se subjekti me anë të kërkesës se tij është pajisur nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier me një vërtetim hipotekor, i cili në bazë të ligjit jepet në momentin që subjekti i ka shlyer të gjitha detyrimet tatimore, dhe në rastin aktual subjekti ka pasur si detyrim tatimor, tatimin e fitimit në shitje, detyrim të cilin subjekti e ka paguar për të marrë vërtetimin hipotekor, detyrim i cili duhej deklaruar në pasqyrën financiare të rubrikës të ardhurat, si e ardhur nga aktiviteti i tij, gjë që subjekti nuk e ka bërë. Gjithashtu, nga kontrolli i bërë nga ana e inspektorit të kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore, Fier, në momentin e kontrollit është konstatuar se apartamentet kanë qenë të banuara dhe në bazë të nenit 124, të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, subjektit i ka lindur detyrimi i mësipërm. Madje me vonë, po me anë të kërkesës së tij Nr. 888, datë 21.08.2009, subjekti ka kërkuar rimbursimin e këtij tatim fitim për detyrime të tjera tatimore të cilat i ka pasur ky subjekt ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, veprim ky i pabazuar, pasi kjo shumë nuk është tepricë kreditore, por është detyrim i mirëfilltë tatimor, pasi është e ardhur nga aktiviteti dhe nuk mund të rimbursohet.
- Në lidhje me pretendimin e palës paditëse për konstatimin e aktit administrativ, njoftim vlerësimi, si absolutisht të pavlefshëm, nuk është i bazuar në ligj, në bazë të nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative. Sa u argumentua më lart, vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, Nr. 1756, datë 20.09.2012, është i pabazuar dhe në kundërshtim të hapur me ligjin.

Kundër vendimit Nr. 1756, datë 20.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, në datë 08.10.2012, ka paraqitur ankim edhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, duke parashtruar këto shkaqe për ndryshimin e vendimit Nr. 1756, datë 20.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier:

- Nga kontrolli i dokumentacionit, fatura shitje-blerje dhe libra shitje-blerje të palës paditëse, rezulton, sipas pasqyrës financiare, se nuk rakordon qarkullimi total me të ardhurat e deklaruara në bilancin financiar, nuk rakordojnë blerjet e deklaruara në situatën financiare të TVSH-së, me blerjet e deklaruara në bilancin financiar të vitit 2010.
- Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier, ka krahasuar të ardhurat e deklaruara në bilancet financiare të vitit 2010, nga ku ka rezultuar se ka ndryshime nga të ardhurat e deklaruara në situatën financiare të TVSH-së në sistemin informatik për vitin 2010, në vlerën 5.537.000 lekë dhe se ky ndryshim vjen si rezultat i rivlerësimit të shitjeve të kryera nga akt-kontrolli. Pra, në kundërshtim me nenin 128, të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* duhet të rivlerësohen edhe të ardhurat për efekt të tatim-fitimit, si periudhë e mbyllur tatimore, dhe si rezultat lind detyrimi 830.550 lekë nga ku 553.700 lekë detyrim tatimi për vitin 2010 dhe 276.850 lekë gjobë tatim-fitimi.
- Karburanti i konsumuar dhe vaji në shërbim të aktivitetit të kryer ndaj kompanisë “Stream Oil & Gas”, është shërbim i përjashtuar nga TVSH, por duke iu referuar shitjeve pjesa e kreditueshme e karburantit njihet duke lindur detyrimi total 250.040 leke nga ku detyrimi i TVSH-së në shumën 200.032 lekë, ndërsa gjoba 50.008 lekë. Pra rezulton se mesatarja majore e konsumit të karburantit është rreth 500.000 lekë, por subjekti pretendon se ka blerë karburant në vlerën 4.213.551 lekë, kur totali i shitjeve për muajin dhjetor ishte 5.800.000 lekë, duke ngritur pretendimin e konsumimit të sondave të dhëna me qira, pa u sanksionuar në kontratat respektive se qiradhënësi do të paguajë vlerën e karburantit. Për rrjedhojë, palës paditëse me të drejtë i është njohur nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, si shpenzim për karburant mesatarja sipas muajve të tjerë, duke iu klasifikuar si shpenzim i pajohur vlera 3.700.000 lekë.
- Sipas nenit 115 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”* totali i detyrimit është 462.500 lekë nga ku detyrim tatim-fitimi 370.000 lekë dhe gjobë TVSH 92.500 lekë.
- Rezulton se subjekti “Silvi Konstruktion” SHPK, është investitor i një objekti shumëkatësh në lagjen “Konferenca e Pezës”, Fier, me vlerë të llogaritur të apartamenteve 98.897.699 lekë. Nga kontrolli ka rezultuar se i është llogaritur tatim fitimi me shitje me tregues minimale fiskale, të cilin subjekti e ka paguar pa e pasqyruar në situatën financiare të shoqërisë, duke kërkuar kompensimin e tatimit për të mbuluar tatim-fitimin e veprimtarive të tjera. Nga kontrolli rezulton se subjekti ka deklaruar të shitura deri tani 1.623 m² apartamente banimi, me çmim mesatar 27.754 leke, çmim nën tregun minimal fiskal, ndërkohë që nga kontrolli ka rezultuar se subjekti i ka të gjitha ambientet e banueshme. Sipas vërtetimit për efekt hipotekimi sipërfaqja e banueshme 4.196 m², ndaj pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier, sipas vendimit Nr. 173, datë 29.03.2006 “Mbi miratimin e kostos minimale fiskale në ndërtim dhe për mënyrën e përcaktimit të çmimit të shitjes së banesave, çmimi minimal fiskal, për Fierin, Udhëzimin Nr. 2 datë 26.02.2009, “Për ndryshimin e Udhëzimit nr. 9, datë 26.02.2008, “Për tatim fitimin në kalimin e pronësisë se paluajtshme” ku fitimi minimal është 40 Euro/m² ka llogaritur si total fitimi të padekluarur shumën 167.840 Euro, pra 23.497.600 lekë. Në zbatim të nenit 124 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, ligjit Nr. 8438, datë 28.12.2008, *“Për tatimin mbi të ardhurat”* detyrim tatim-fitimi është në vlerën 2.349.760 lekë dhe po e njëjta shumë zbatohet në formë gjobe.

Pra detyrimet dhe gjobat që duhet të paguaje subjekti “Silvi Construksion” SHPK janë në vleftën 6.242.610 lekë.

- Me Vendimin Nr. 18749/1 Prot., datë 16.12.2011, të Drejtorisë së Apelit Tatimor, Tiranë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është vendosur: “Refuzimi i ankimit për anulimin e detyrimeve të përcaktuara në njoftim vlerësimin për detyrimin tatimor Nr. 13556 Prot., datë 09.09.2011, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Fier, për arsye se e konsideron ankimin të papranueshëm, pasi nuk është bërë pagesa e plotë e detyrimit tatimor, objekt ankimi, në shumën 2.666.551 lekë.
- Paditësi, Shoqëria tregtare “Silvi Construksion” SHPK, nuk arriti të arsyetojë gjatë gjykimit dhe nuk dha asnjë provë dhe argument ligjor se, përse Vendimi Nr. 13556 Prot., datë 09.09.2011, i Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier dhe Vendimi Nr. 18749/1 Prot., datë 16.12.2011, i Drejtorisë së Apelit Tatimor duhet të konstatohen si të pavlefshme dhe se **ku qëndron paligjshmëria dhe në kundërshtim me cilin ligj janë nxjerrë këto vendime.**
- **Paditësi “Silvi Construksion” SHPK, nuk ka paraqitur prova të bazueshmërisë në ligj të kërtimeve të tij sipas dispozitave ligjore, ndaj pretendimet nuk janë të mbështetura në prova dhe në ligj. Si konkluzion avokatura e shtetit kërkoj ndryshimin vendimit të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë.**

Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin Nr. 620, datë 08.04.2014, ka vendosur: “Të shpallë moskompetencën lëndore të Gjykatës së Apelit Vlorë për gjykimin e çështjes dhe dërgimin e saj në gjykatën kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit.”

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT,

Në dhomë këshillimi, si verifikoi se palët ndërgjyqëse kishin dijeni rregullisht për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të shqyrtimit të çështjes, me shpalljen e datës 19.04.2016, në konformitet me përcaktimet e nenit 49(2), fjalia e dytë, të ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 482(2) të K.Pr.Civile;

pasi u njoh me *relacionin e përgatitur nga gjyqtari Amarildo Laçi,*

konstatoi se ankimet e paraqitura nga pala e paditur dhe avokatura e shtetit ishin paraqitur tej afatit ligjor dhe e përballi këtë situatë faktike me normat relevante procedurale civile,

V Ë R E N:

1. Ankimet e paraqitura nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, kundër vendimit Nr. 1756, datë 20.09.20125, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, janë paraqitur përtej afatit 15 ditor, të parashikuar nga neni 443 i Kodit të Procedurës Civile (K.Pr.Civile). Për pasojë, duhet vendosur mospranimi i ankimeve (kthimi i tyre), në përputhje me parashikimet e nenit 50, germa “a” të ligjit Nr. 49/2012, të zbatuar së bashku me germën “a”, të paragrafit të parë, të nenit 450 të K.Pr.Civile.

I. Rrethanat e çështjes:

2. Pala paditëse Shoqëria “Silvi Construksion” SHPK, është regjistruar si shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me objekt në fushën e ndërtimit, import, eksport, transport udhëtarësh,

hoteleri, investitor. Në fushën e tregtimit me pakicë të lëndëve djegëse, hidrokarbureve, dhe nënprodukteve të tyre.

3. Nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, është ushtruar kontroll pranë palës paditëse, Shoqëria "Silvi Konstruktion" SHPK, për vitin financiar 2010-2011, ku është nxjerrë një detyrim në total prej 6,254,191 (gjashtë milionë e dyqind e pesëdhjetë e katër mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) lekësh.

4. Paditësi, Shoqëria "Silvi Konstruktion" SHPK me shkresën numër 10893/4 datë 22.08.2011, i ka paraqitur një observacion palës së paditur, Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, për projekt-raportin e dërguar, me pretendimin se përlllogaritjet ndryshojnë, duke kërkuar anulimin e detyrimeve të vendosura nga pala e paditur. Paditësi, Shoqëria "Silvi Konstruktion" SHPK me shkresën numër 11622, datë 20.07.2011, i ka paraqitur, Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier, kërkesë, për kompensimin e detyrimeve tatimore të shoqërisë, me qëllim që shumën e nevojshme që duhej të paguanin për ankimin të mbahej nga detyrimet që pala e paditur i kishte në lidhje me TVSH-në e pakthyer.

5. Me shkresën numër 10893/3 Prot., datë 29.08.2011, pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, Drejtoria e Kontrollit, i ka komunikuar, kontrollin përfundimtar si dhe njoftim vlerësimit, subjektit Shoqëria "Silvi Konstruktion" SHPK, për detyrimin që ka ndaj palës së paditur.

6. Pala paditëse i është drejtuar me ankim, Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme së Tatimeve, e cila me vendimin numër 18749/1 Prot., datë 16.12.2011 ka vendosur refuzimin e ankimit për anulimin e detyrimeve të palës paditëse, pasi nga pala paditëse nuk është bërë pagesa e plotë e detyrimit tatimor.

7. Pala paditëse, Shoqëria "Silvi Konstruktion" SHPK, ka pretenduar se akti administrativ, njoftim vlerësimi tatimor Nr. 13556 datë 09.09.2011, është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, pasi është nxjerrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar. Nuk është respektuar parimi i njoftimit, e drejta për t'u dëgjuar dhe ankimuar njoftim vlerësimi tatimor Nr. 13556, datë 09.09.2011, të drejta këto të parashikuara në ligjin Nr. 9920 datë 19.05.2008, "*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*".

8. Pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, në mënyrë të përmbledhur ka prapësuar se, ndaj palës paditëse shoqëria "Silvi Konstruktion" SHPK, është ushtruar kontroll nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore, Fier dhe është ngarkuar me një detyrim në shumën 6,242,610 lekë. Ky detyrim i është ngarkuar palës paditëse, pasi nuk i rakordojnë qarkullimi total me të ardhurat e deklaruara në bilancin përfundimtar, si dhe blerjet e deklaruara në situatën financiare me TVSH, me blerjet e deklaruara në bilancin financiar të vitit 2010. Në këtë rast nuk gjen zbatim neni 116 i Kodit të Procedurave Administrative për pavlefshmërinë absolute të një akti administrative siç pretendoi pala paditëse.

9. Ndërsa përfaqësuesi i avokaturës së shtetit ka shtuar se, nuk plotësohen kushtet e nenit 116 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi institucioni që ka nxjerrë aktin administrativ është

Drejtoria Rajonale Tatimore Fier. Kjo drejtori ka vepruar brenda kompetencave të saj ligjore dhe akti ka dalë konform formës e procedurës ligjore të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

9.1. Avokatura e shtetit ka prapësuar se, nga kontrolli i ushtruar pranë subjektit nuk rakordon qarkullimi total me të ardhurat e deklaruar në bilancin financiar. Nuk rakordojnë blerjet e deklaruar në situatën financiare të TVSH-së, me blerjet e deklaruar në bilancin financiar të vitit 2010.

10. Avokatura e shtetit, zyra vendore Vlorë, me datë 06.05.2016, brenda afatit 5-ditor të parashikuar në nenin 49/2 të Ligjit Nr. 49/2012, ka depozituar parashtrimet e saj në Gjykatën e Apelit Administrativ, nëpërmjet të cilave ka invokuar të njëjtat pretendime të paraqitura në ankimin e tyre kundër vendimit të shkallës së parë.

II. Arsyetimi i vendimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier

11. Në rastin konkret Gjykata, në analizë të provave shkresore të administruara gjatë hetimit gjyqësor dhe të fakteve, çmon se padia duhet të pranohet me arsyetimin si më poshtë vijon: Në nenin 116 të Kodit të Procedurës Administrative përcaktohet se: *“Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshme, në kuptimin e këtij Kodi, në rastet e mëposhtme: a) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ i paidentifikuar; b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; c) kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.”*

12. Ndërsa neni 117 i Kodit të Procedurave Administrative parashikon: *“1. Aktet administrative absolutisht të pavlefshme nuk prodhojnë pasoja ligjore pavarësisht nga fakti nëse janë deklaruar apo jo si të tillë. 2. Secila palë e interesuar mund të kërkojë që akti administrativ të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kërkesa në fjalë mund të bëhet në çdo kohë. Organi administrativ kompetent, me nismën e tij, mundet të deklarojë një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm në çdo kohë. 3. Në qoftë se vetëm një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme, i gjithë akti do të konsiderohet absolutisht i pavlefshëm, në rast se pjesa që anulohet është aq e rëndësishme saqë pa të akti nuk e realizon qëllimin e tij.”*

13. Në nenin 32 të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, përcaktohet se: *“Çdo tatimpagues ka të drejtë të marrë njoftim për çdo akt administrativ veprim ose mosveprim, të bërë për mbledhjen e detyrimeve tatimore, i cili prek pasurinë e tij, me përjashtim të rasteve kur administrata tatimore vlerëson se ekziston rreziku real që, pas marrjes se njoftimit, tatimpaguesi ta transferonte pronësinë para përfundimit të vlerësimit tatimor”.*

14. Në nenin 34 të këtij ligji përcaktohet se: *“1. Në rastin e një mosmarrëveshjeve për vlerësimin tatimor, të bërë nga administrata tatimore tatimpaguesi ka të drejtë të marrë përgjigje me shkrim, në lidhje me arsyet dhe mënyrën e vlerësimit dhe të vendimit të marrë. 2. Në bazë të kërkesës me shkrim të tatimpaguesit, administrata tatimore lëshon vërtetim për të ardhurat e tatueshme, për detyrimet tatimore të mbetura, si dhe për pagesat e kryera nga tatimpaguesi.”*

15. Ndërsa në nenin 37 të ligjit të sipërcituar sanksionohet se: *“Tatimpaguesi, përpara marrjes së një vendimi administrativ për të dhe pasurinë e tij, ka të drejtë të dëgjohet nga administrata tatimore”*. Ndërkohë që neni 38 parashikon se: *“Tatimpaguesi gëzon të drejtën e ankimit dhe të sigurimit për një shqyrtim të pavarur administrativ të çështjeve të lidhura me të.”*

16. Gjithashtu këto parime janë sanksionuar edhe në Udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008 *“Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, sipas të cilit, pika 32:

“Tatimpaguesit kanë të drejtë të njoftohen në kohë për çdo akt administrativ të administratës tatimore të nxjerrë në emër të tyre dhe që prek pasurinë apo detyrimet tatimore të tyre. Ata kanë të drejtë gjithashtu që të njihen me arsyet dhe bazën ligjore të nxjerrjes së aktit administrativ. Nga ana tjetër, administrata tatimore, bazuar në nenin 69 të ligjit, ka detyrimin të dërgojë në kohë çdo vendim administrativ të nxjerrë prej saj për tatimpaguesin, si dhe të japë bazën ligjore dhe çdo shpjegim tjetër të duhur, duke e informuar njëkohësisht tatimpaguesin edhe për të drejtat dhe detyrimet që lidhen me këtë vendim. Ky detyrim nuk respektohet nga administrata tatimore vetëm kur ajo zotëron prova konkrete dhe të besueshme se tatimi është në rrezik.”

17. Ndërkaq, pika 34 e udhëzimit të cituar më sipër parashikon: *“1. Tatimpaguesit kanë të drejtë të presin nga administrata tatimore zbatimin korrekt të ligjit, në mënyrë që çdonjëri prej tyre të marrë të drejtat që i takojnë dhe të paguajë shumën e duhur të detyrimit tatimor. Ata kanë të drejtë të pretendojnë të shikojnë tek administrata tatimore një administratë të besueshme për atë që bën. Tatimpaguesit kanë të drejtë të paraqesin të gjitha pretendimet e tyre në lidhje me një vlerësim tatimor të administratës tatimore. Tatimpaguesit, të cilët nuk janë dakord me një vlerësim tatimor të administratës tatimore, kanë të drejtë të marrin përgjigje me shkrim për pretendimet e tyre, ku jepen të gjitha arsyet e vlerësimit tatimor, mënyra e vlerësimit dhe të drejtat e detyrimit lidhur me këtë vlerësim.”*

18. Ndërsa në pikën 34.2 të udhëzimit përcaktohet: *“Me kërkesën me shkrim të tatimpaguesit, administrata tatimore është e detyruar që brenda një afati prej jo më shumë se 5 ditë pune nga data e protokollimit të kërkesës në organin tatimor, të lëshojë vërtetime që konfirmojnë situatën tatimore të tatimpaguesit lidhur me pagimin e detyrimeve tatimore, të ardhurat e tatueshme, detyrimet tatimore të papaguara, etj.”*

19. Ndërsa, në pikën 37, parashikohet se: *“Përpara marrjes së një vendimi ekzekutiv nga ana e administratës tatimore, tatimpaguesi ka të drejtë të presë nga kjo e fundit që të dëgjohet me vëmendje për të dhënë sqarimet e nevojshme, për të parashtruar pretendimet që ka, për të shpjeguar rrethanat konkrete, etj. Ai ka të drejtë gjithashtu të sigurohet se shpjegimet dhe pretendimet e tij do të shqyrtohen me vëmendje e ndershmëri nga administrata tatimore në funksion të marrjes së vendimeve të drejta dhe në konformitet me ligjet tatimore.”*

20. Në interpretim të këtyre dispozitave organi tatimor para nxjerrjes së një akti administrativ ka detyrimin që të njoftojë subjektin që mund të preket nga ky akt, ta informojë atë me shkrim për kundërshtimet që ka si dhe të dëgjojë shpjegimet e subjektit, fakte që nuk kanë ngjarë në çështjen në gjykim, sipas akteve të ndodhura në dosje. Ndërkohë që pala paditëse ka bërë kundërshtimet e saj me observacionin 10893/4 Prot., datë 22.08.2011, ndaj njoftim vlerësimit tatimor, ku ka kundërshtuar rivlerësimin e bërë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, duke

pretenduar se përlllogaritet ndryshojnë dhe duke i kërkuar anulimin e detyrimeve. Nga ana e palës së paditur nuk është kthyer përgjigje në lidhje me këtë observacion, në këto kushte paditësi me shkresën nr. 11622 Prot., datë 20.07.2011, i është drejtuar palës së paditur duke i kërkuar që t'i kreditojë TVSH-në me qëllim që shuma e nevojshme që duhej të paguante për ankimimin të mbahej nga detyrimet që pala e paditur i kishte në lidhje me TVSH-në e pakthyer. Edhe në lidhje me këtë shkresë nga ana e palës së paditur nuk është kthyer asnjë përgjigje. Nga ana e palës së paditur me shkresën Nr. 10893/6 Prot., datë 29.08.2011, i është komunikuar palës paditëse raporti përfundimtar si dhe njoftim vlerësimi tatimor.

21. Në këto kushte gjykata çmon se pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier gjatë procedimit administrativ të zhvilluar nuk ka zbatuar detyrimet e rrjedhura nga neni 51 e vijues i K.Pr.Administrative, i cili parashikon të drejtën e çdo personi i interesuar për t'u informuar nga administrata në lidhje me zhvillimin e procedimeve për të cilat ai është i interesuar.

22. Në nenin 56 të K.Pr.Administrative është parashikuar: *“Palët e interesuara duhet të njoftohen për të gjitha aktet administrative nëpërmjet të cilave: a) merren vendime në lidhje me pretendimet e tyre; b) vendosen detyrime, ndëshkime ose shkaktohen dëme; c) krijohen, zhduken, zgjerohen apo kufizohen interesat apo të drejtat legjitime të palëve, ose preken në ndonjë mënyrë tjetër kushtet për ushtrimin e tyre.”*

23. Në nenin 58 të K.Pr.Administrative është parashikuar edhe forma përmbajtja e njoftimit për personin e interesuar, pra duhet që në çdo rast personi i interesuar për aktin, pra personi të cilit nga akti i cenohen interesat e tij duhet, jo vetëm të njoftohen për të marrë pjesë në procedimin administrativ të zhvilluar në këtë rast, por edhe që njoftimi të bëhet në një formë të caktuar, pra të përmbajë të gjithë elementet që procesi administrativ shqyrton.

24. Në këto kushte, gjykata çmon se pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier, ka cenuar të drejtën e palës paditëse shoqërisë Silvi Konstruktion” SHPK, për një proces administrativ të rregullt e ligjor, duke i hequr të drejtën dhe mundësinë për të marrë pjesë në një proces administrativ në mënyrë aktive, nëpërmjet paraqitjes së akteve apo pretendimeve të veta si dhe nuk ka kthyer përgjigje në lidhje me pretendimet kësaj pale.

25. Si rrjedhim, kjo e bën aktin administrativ të pavlefshëm, në kuptim të nenit 116 të K.Pr.Administrative. Në përfundim Gjykata, çmon se kërkesë padia duhet të pranohet si e bazuar ligj e prova.

III. Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit

26. Gjykata Administrative e Apelit, çmon se në rastin në gjykim, duhet operuar me mospranimin e ankimeve të paraqitura nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier, dhe Zyra Vendore e Avokaturës së Shtetit, Vlorë, pasi përfaqësuesit e tyre, edhe kanë qenë të pranishëm në seancën gjyqësore të datës 20.09.2012, ku u shpall vendimi përfundimtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, nuk e kanë ankimuar atë brenda afatit 15 ditor, të parashikuar në Kodin e Procedurës Civile.

27. Pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier, në seancën gjyqësore të datës 20.09.2012 (data e shpalljes së vendimit) ka qenë e pranishme, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, Shkëlqim Kamberi, ndërkohë që Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, përfaqësohej nga avokati i shtetit, Endri Kotherja.

28. Pala e paditur, edhe pse e ka përpiluar aktin e ankimit me shkresën Nr. 12708 Prot., datë 03.10.2012, ajo e ka nisur atë me anë të shërbimit postar shtetëror, në referencë të nenit 446 të K.Pr.Civile) në datë 08.10.2012.

29 Sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, në datë 09.10.2014, i ka komunikuar palës paditëse, Shoqëria "Silvi Konstruktion" SHPK, ankimin e palës së paditur (neni 447 i K.Pr.Civile) dhe në datë 10.10.2014, dosja gjyqësore është nisur për kompetencë gjykimi, Gjykatës së Apelit Vlorë. Kjo e fundit, në datë 14.11.2012, e ka regjistruar atë në regjistrin themeltar, me nr. 2374.

30. Avokatura e shtetit, Zyra Vendore Vlorë, e ka përpiluar aktin e ankimit me shkresën Nr. 2522 Prot., datë 05.10.2012 dhe e ka dorëzuar pranë sekretarisë gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, në referencë të nenit 446 të K.Pr.Civile) në datë 08.10.2012.

31. Sekretaria gjyqësore e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier, në datë 08.10.2012, i ka komunikuar paditësit, Shoqëria "Silvi Konstruktion" SHPK, ankimin e Avokaturës së Shtetit, Zyra Vendore Vlorë (neni 447 i K.Pr.Civile) dhe në datë 09.10.2012, paditësi ka marrë dijeni për këtë ankim të paraqitur nga Avokatura e Shtetit.

32. Me vendimin Nr. 620, datë 08.04.2014, një këshill gjyqësor i Gjykatës së Apelit, Vlorë, duke mos e gjetur veten kompetent në lëndë, pasi ndërkohë kishte hyrë në fuqi ligji 49/2012, datë 03.05.2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"* dhe kishin filluar veprimtarinë gjykatat administrative të të gjitha shkallëve, në zbatim edhe të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Nr. 4/2013, ia dërgoi aktet për kompetencë kësaj Gjykate (Administrative të Apelit). Kjo e fundit e regjistroi këtë çështje në regjistrin themeltar me nr. 5633/1201/46, në datë 01.07.2014. Me shortin e datës 31.03.2016, kjo çështje iu caktua këtij kolegji gjykues.

33. Ky kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit, në dhomën e këshillimit të datës 12.05.2016, pasi verifikoi se palët ndërgjyqëse kishin dijeni rregullisht për datën, orën dhe vendin e zhvillimit të shqyrtimit të çështjes, me shpalljen e datës 19.04.2016, në bazë të përcaktimeve të nenit 49(2), fjalë e dytë, të ligjit Nr. 49/2012, në lidhje me nenin 482(2) të K.Pr.Civile, u njoh me relacionin e gjyqtarit kryesues, konstatoi se ankimet e paraqitura nga pala e paditur dhe avokatura e shtetit, Zyra Vendore Vlorë, ishin paraqitur tej afatit ligjor 15 ditor të parashikuar në nenin 443 të K.Pr.Civile. Kjo dispozitë, në paragrafin e parë të saj, sanksionon se: *"Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë."*

34. Gjykata e Apelit Administrativ vëren se, ligji i gjykatës Nr. 49/2012 (*lex fori*), në nenin 44 të tij, me të cilin fillon kreu i VII-të, i titulluar "Ankimi", parashikon se: *"Mjetet dhe afatet e*

ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj.”.

35. Nga përmbajtja e dispozitave të cituara *supra*, Gjykata e Apelit arrin në përfundimin se afati i ushtrimit të së drejtës së ankimit kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë është 15 ditë, afat që fillon të ecë nga e nesërmja e shpalljes apo e komunikimit të vendimit, siç kanë arritur në qëndrimin e tyre unifikues Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin Nr. 2, datë 27.03.2012.

36. Siç u pasqyrua më lart, pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, e ka paraqitur ankimin me anë të shërbimit postar, në datë 08.10.2012. Data 08 tetor 2012 është tre ditë jashtë afatit 15 ditor, që ka përfunduar në datë 05.10.2012, sipas llogaritjes së tij, në referim të paragrafit të parë, të nenit 148 të K.Pr.Civile. Nga ana tjetër, konstatohet se data 05 tetor 2012 ka qenë ditë e premte, pra ka qenë ditë normale pune, për çka nuk gjejnë zbatim përjashtimet e parashikuara në paragrafin e tretë, të nenit 148 të K.Pr.Civile.

37. Gjithashtu, Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë e ka paraqitur në datë 08.10.2012. Data 08 tetor 2012 është tre ditë jashtë afatit 15 ditor, që ka përfunduar në datë 05.10.2012, sipas llogaritjes së tij, në referim të paragrafit të parë, të nenit 148 të K.Pr.Civile. Nga ana tjetër, konstatohet se data 05 tetor 2012 ka qenë ditë e premte, pra ka qenë ditë normale punë, për çka nuk gjejnë zbatim përjashtimet e parashikuara në paragrafin e tretë, të nenit 148 të K.Pr.Civile.

38. Gjithsesi, ky kolegji çmon të vërë në dukje se pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit, e kanë humbur afatin për të ankimuar vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë në gjykatën e apelit, pasi nuk kanë vepruar në kohë (brenda 15 ditëve duke filluar nga e nesërmja e shpalljes apo njoftimit të vendimit përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, sipas nenit 316 të K.Pr.Civile).

39. Kodi i Procedurës Civile, në nenin 450 të tij, në pjesën relevante, parashikon:

“Gjykata që ka dhënë vendimin nuk e pranon ankimin, kur:

a) është paraqitur jashtë afatit.

(...)

Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi.

Kundër vendimit për kthimin e ankimit mund të bëhet ankim i veçantë.”.

40. Ndërkohë që neni 50 i *lex fori*, në paragrafin e parë, shkronja “a” përcakton:

“Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos:

a) mospranimin e ankimit, në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë.

(...)”

41. Kolegji i Apelit Administrativ konstaton se, në zbatim të germës “a”, të paragrafit të parë, të nenit 450 të K.Pr.Civile, *së pari*, ishte detyrë e gjykatës që ka dhënë vendimin e ankimit (Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier) që të vendoste mospranimin apo kthimin e ankimeve të paraqitura nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier dhe Avokatura e Shtetit, Zyra

Vendore Vlorë. I njëjti detyrim qëndronte, *së dyti*, edhe mbi Gjykatën e Apelit, Vlorë, por të dy gjykatat nuk e kanë konstatuar një fakt të tillë.

42. Gjithsesi, është detyrë edhe Gjykatës Administrative të Apelit, në zbatim të paragrafit të dytë, të nenit 450 të K.Pr.Civile, në lidhje me nenin 50(1)-a të ligjit Nr. 49/2012, që të deklarojë, kryesisht, mospranimin apo kthimin e ankimeve të paraqitura nga pala e paditur dhe Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Vlorë, për shkak të mosrespektimit të afatit për të ushtruar të drejtën e ankimit kundër vendimit përfundimtar Nr. 1756, datë 20.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Administrative e Apelit, mbështetur në nenin 50, germa "a" të ligjit Nr. 49/2012, datë 03.05.2012 "*Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*", i ndryshuar dhe nenin 450(1)-a të K.Pr.Civile,

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankimeve të paraqitura nga pala e paditur, Drejtoria Rajonale Tatimore, Fier, dhe Avokatura e Shtetit, kundër vendimit të vendimit Nr. 1756, datë 20.09.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier.
2. Kundër vendimit mund të ushtrohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, brenda 30 ditëve, duke filluar nga e nesërmja e njoftimit të tij.

- *U shpall në Tiranë, më 12.05.2016.*

A N Ë T A R
BARI SHYTI
(d.v)

A N Ë T A R E
LINDITA SINANAJ
(d.v)

K R Y E S U E S
AMARILDO LAÇI
(d.v)

E njesuar me origjinalin

Kancelari
Leonard Stekaj
Stekaj